



Tiranë, 23 shtator 2008

## **FMN diskuton me qeverinë për buxhetin e 2009 dhe situatën e trazuar financiare botërore**

*Kjo deklaratë paraqet përfundimet e misionit të FMN-së që vizitoi Shqipërinë në 17-23 shtator për të diskutuar me autoritetet zbatimin e buxhetit të 2008, buxhetin e 2009, politikat e sektorit monetar dhe financiar dhe progresin në reformat strukturore, kryesisht në privatizimin e kompanisë së shpërndarjes së energjisë.*

Prirjet makroekonomike mbeten të favorshme, me rritje të fortë në rreth 6% parashikuar për këtë vit dhe tjetrin, si dhe inflacion brenda kufirit objektiv të Bankës së Shqipërisë. Ndërkohë, studime ndërkombëtare kanë vënë në dukje së fundmi përmirësimin e klimës së biznesit. Megjithatë, këto arritje po ndodhin në një kohë kur tregjet financiare botërore janë të trazura. Duke qenë se Shqipëria është gjithmonë e më shumë një partner në ekonominë botërore, kjo kërkon politika të matura ekonomike dhe financiare në të ardhmen, aq më tepër në një vit elektoral.

Duke u kthyer tek buxheti i 2008, megjithë përmirësimet në normat e zbatimit, shpenzimet kapitale janë ende poshtë nivelit të planifikuar në buxhet dhe me ritmin aktual deficioni buxhetor në 2008 do të jetë më poshtë sesa niveli 5.2% i PBB-së i rënë dakord. Pozicioni më i shtrënguar fiskal ka ndihmuar Bankën e Shqipërisë për të siguruar stabilitetin e çmimeve dhe ka kufizuar zgjerimin edhe më tej të deficionit të llogarisë korrente, por nga ana tjetër kjo rrezikon rrudhjen e fondeve për sektorët prioritarë. Për këtë arsye, misioni i bën thirrje autoriteteve të rishikojnë me kujdes shpenzimet aktuale për të siguruar që do t'i kushtohet rëndësi e mjaftueshme investimeve në sektorët prioritarë, po qe e nevojshme nëpërmjet një tjetër buxheti suplementar.

Për të ruajtur stabilitetin markoekonomik, sidomos në klimën aktuale të trazuar në mjedisin financiar botëror, është e domosdoshme të evitohet stimuli fiskal në 2009. Në situatën aktuale, ne kemi rekomanduar kufizimin e deficionit në 2009 në nivelin 3–3 ½ përqind e PBB-së. Në të ardhmen dhe pasi programi i FMN-së të ketë përfunduar, ne i inkurajojmë autoritetet që t'i përmbahen një objektivit të qartë fiskal që do të ankorojë politikat dhe do të ndihmojë në aksesin e synuar në tregjet ndërkombëtare të kapitalit.

Ne i mbështesim rregulloret e miratuara së fundmi nga Banka e Shqipërisë për mbikqyrje shtesë bankare, sidomos rritjen e provigjionimit për huanë në valutë, të cilat duhet të ndihmojnë për të frenuar rritjen e kredisë dhe deficionin e llogarisë korrente. Në të ardhmen, ne e inkurajojmë Bankën e Shqipërisë të ndërmarrë monitorime edhe më të shpeshta të transaksioneve bankare, përfshirë këtu edhe pozicionet në valutë. Banka e Shqipërisë duhet gjithashtu të vazhdojë përpjekjet për të vendosur memorandume mirëkuptimi me mbikqyrësit në vendet e bankave mëmë. Si edhe në të



INTERNATIONAL MONETARY FUND  
RESIDENT MISSION IN ALBANIA

shkuarën, Banka e Shqipërisë duhet të jetë e gatshme për të reaguar kundër çdo përkeqësimi në pritshmëritë për inflacionin, përfshirë këtu edhe nëpërmjet rritjes së interesave.

Formalizimi i ekonomisë në Shqipëri është një qëllim i rëndësishëm. Megjithatë kjo nuk duhet bërë duke u mbështetur në masa administrative që janë barrë dhe shtojnë mundësinë për abuzivizëm dhe korrupsion. Përkundrazi, masa që nxisin vetë-deklarimin janë të nevojshme. Në këtë kontekst ne këshillojmë kundër uljes së normës së kontributit të sigurimeve shoqërore. Hapësira fiskale duhet të ruhet për të financuar një reformë pensioni që do të përmirësonte lidhjen midis kontributeve dhe përfitimeve, duke ofruar kështu nxitjen e nevojshme për vetëzbatim.

Ka pasiguri të mëdha përsa i përket të dhënave të llogarive kombëtare dhe ne e nxitim INSTAT-in të vazhdojë të përdorë mirë asistencën teknike të huaj që është e disponueshme në këtë fushë.

Misioni mirëpret fillimin e procesit të privatizimit për kompaninë e shpërndarjes së energjisë. Pavarësisht nga ky proces, do të jetë e rëndësishme që të ruhet përqëndrimi dhe të vazhdohet me përmirësimin e treguesve të arkëtimeve dhe humbjeve, pasi megjithë progresin e bërë kohët e fundit, arkëtimet mbeten poshtë nivelit objektiv, duke reflektuar pjesërisht edhe mospagesën nga institucionet publike. Për të kufizuar humbje të reja për KESH-in dhe në përputhje me programin aktual PRGF/EFF, është mjaft e rëndësishme që kufizimet ekzistuese në sasinë e importeve të respektohen.

Një mision rishikimi i FMN-së do të vizitojë Tiranën në fillim të nëntorit. Në rast se arrihet marrëveshje për politikën, përfshirë këtu edhe buxhetin e vitit 2009, pritet që rishikimi i gjashtë dhe i fundit i programit t'i paraqitet bordit ekzekutiv të FMN-së në janar të 2009.

Misioni dëshiron të falenderojë autoritetet për bashkëpunimin e tyre të vazhdueshëm dhe mikpritjen e ngrohtë.

Gerwin Bell  
Shef Misioni

Ann-Margret Westin  
Përfaqësuese e Përhershme